

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7041
E martë, 7 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

RACIZMI I HAGËS DHE RACIZMI I PRISHTINËS

FAQE 2

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI
I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (7)

FAQE 4-5

MASAKRIMI I PLEQVE ME SËPATA



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e

pjesës së shtatë flet se si forcat serbe në vitin 1999 kanë hyrë në shtëpitë e shqiptarëve duke masakruar pleq me sëpata. "Banorët që nuk kishin mundur

të largoheshin nga fshati u detyruan të futeshin në shtëpi të padëmtuara dhe aty u ekzekutuan", ka theksuar Bardhyl Mahmuti

AKTUALE



MINISTRIA E SHËNDETËSISË
NË GAZË RAPORTON PËR RRIJJE
TË NUMRIT TË VIKTIMAVE F. 2

BERISHA SHPËRFILL VENDIMIN
E GJYKATËS, NUK PARAQITET
NË POLICINË GJYQËSORE F. 7

KRASNIOI VIZITON FAMILJEN
E ISNI KILAJT F. 6

EKONOMI



BIZNESET E GRAVE QË I UDHËHEQIN
BURRAT F. 8

KURTI DHE ALIU PROMOVOJNË
ZVOGËLIMIN E PËRDORIMIT
TË QESEVE TË PLASTIKËS F. 8

SPORT



DY SUPERNDESHJE NË
GRUPIN F F. 10

DEDAJ THOTË SE NUK
ËSHTË MALTRETUAR NGA
UÇK-ja: AJO BËRI REALITET
LIRINË E KOSOVËS

ISH-AMBASADORI I KOSOVËS NË
MAQEDONINË E VERIUT, GJERGJ
DEDAJ, KA FILLUAR DËSHMINË
NË GJYKATËN SPECIALE

FAQE 3



IKSHPK-ja:
ENDE KA VLERA
TË LARTA TË
MANGANIT NË
UJIN E LIQENIT
TË BADOCIT

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ministria e Shëndetësisë në Gazë raporton për rritje të numrit të viktimave

GAZË, 6 NËNTOR - Ministria e Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamasi tha se numri i palestinezëve të vrarë gjatë luftës me Izraelin ka kaluar shifrën 10 000. Shifrat e publikuara më 6 nëntor paraqesin luftimet më vdekjeprurëse që nga themelimi i Izraelit 75 vjet më parë. Lufta shpërtheu më 7 tetor kur militantët e Hamasit sulmuan në jug të Izraelit duke vrarë mbi 1 400 persona dhe duke

rrëmbyer afër 240 të tjerë, sipas autoriteteve izraelite. Izraeli u kundërpërgjigj me një fushatë të sulmeve ajrore, pasuar nga një sulm tokësor. Ministria e Shëndetësisë tha se 10 022 persona janë vrarë në Gazë, pa bërë dallimin mes luftëtarëve dhe civilëve. Shumica e viktimave besohet se janë vrarë gjatë sulmeve ajrore izraelite, edhe pse Izraeli ka thënë se mbi 500 raketa të lëshuara nga militantët palestinezë kanë rënë brenda

Gazës. Të hënën forcat izraelite kanë sulmuar veriun e Gazës nga ajri, duke e ndarë nga pjesa tjetër e territorit, teksa forcat tokësore janë futur më thellë brenda qytetit të Gazës. Palestinezët ndërkaq kanë varrosur dhjetëra persona të vrarë një ditë më parë në sulmet izraelite në jug, pjesën ku autoritetet izraelite kanë urdhëruar banorët e Gazës që të evakohen, edhe pse Izraeli po sulmon caqe në gjithë enklavën.



Blinkeni i bindur për përparim në pranimin e Suedisë në NATO

ANKARA, 6 NËNTOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha më 6 nëntor se është i bindur që do të ketë përparim në anëtarësimin e Suedisë në NATO, pas bisedimeve që zhvilloi me homologun e tij turk në Ankara. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, të hënën dërgoi në Parlament projektligjin për ratifikimin e pranimin të Suedisë në aleancën ushtarake të NATO-s, pasi për muaj të tërë kishte bllokuar këtë legjislacion. Legjislacioni duhet të miratohet nga Komiteti për punë të jashtme i Parlamentit, para se t'i dërgohet Asamblesë së Përgjithshme. Më pas, Erdogan duhet ta nënshkruajë atë për t'u shndërruar në ligj. "Jam i bindur se do të shohim një lëvizje



përpara për këtë çështje", tha Blinken për gazetaret para se të largohet nga Ankara, përdërisa u pyet nëse Turqia kishte dhënë

ndonjë garanci për mbështetjen e pranimin të Suedisë në NATO. Blinken tha se ShBA-ja ishte shumë e inkurajuar nga fakti që

Erdogan ka dërguar në Parlament për ratifikim protokollin për pranim, duke shtuar se ky ishte një

"përkushtim i përbashkët" i Ankarasë dhe Uashingtonit. Kryediplomati amerikan tha se pret që të shohë rezultate për këtë çështje. Pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës shkurtin e kaluar, Suedia dhe Finlanda aplikuan për anëtarësim në NATO. Finlanda u bë anëtarja më e re e aleancës në prill, por Suedia ende po pret ratifikimin nga parlamentet e Turqisë dhe Hungarisë. Kreu i Komitetit për punë të jashtme në Parlamentin turk tha javën e kaluar se ai nuk do të përshpejtojë procesin e ratifikimit për pranimin e Suedisë në NATO. Por, gjatë fundjavës Erdogani deklaroi se do të tentojë të lehtësojë këtë proces.

Putini pritët të mbetet në pushtet edhe pas vitit 2024

MOSKË, 6 NËNTOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka vendosur të garojë në zgjedhjet presidenciale të marsit, një vendim i cili do ta mbajë atë në pushtet së paku deri më 2030, pasi ai ndien se i duhet ta udhëheqë Rusinë në periudhën më të rrezikshme në dekadat e fundit, thanë gjashtë burime për agjencinë e lajmeve Reuters. Putini, të cilit ia dorëzoi presidencën Boris Yeltsin në ditët e fundit të vitit 1999, ka shërbyer si president më gjatë se çdo udhëheqës tjetër rus prej Josef Stalinit, madje duke e mposhtur edhe sundimin 18-vjeçar të Leonid Brezhnev. Putini i mbushi 71 vjet më 7 tetor. Burimet, që folën në kushte anonime për shkak të ndjeshmërisë së politikave të Kremlinit, thanë se këshilltarët po përgatiten për fushatën

zgjedhore të Putinit. "Vendimi është marrë - ai do të garojë", tha një prej burimeve, i cili e ka parë planin. Për Putinin, i cili gëzon një mbështetje prej rreth 80 për qind brenda Rusisë sipas sondazheve, zgjedhjet janë formalitet nëse ai merr pjesë: me mbështetjen e shtetit, mediave shtetërore dhe pothuajse pa disidentë publike, ai e ka të sigurt fitoren. Një burim tjetër konfirmoi se vendimi është marrë dhe se këshilltarët e Putinit po përgatiten për pjesëmarrjen e tij në zgjedhje. Të njëjtin konfirmim e dhanë edhe tri burime të tjera: Putini do të garojë. Derisa shumë diplomatë, spiunë dhe zyrtarë të huaj thonë se presin që Putini të qëndrojë në pushtet përjetë, deri më tani nuk ka pasur konfirmim specifik se ai do të garojë në zgjedhjet



presidenciale të marsit 2024. Derisa Putini mund të mos përballet me garë në zgjedhje, ish-spiuni i Shërbimit Sekret Rus (KGB) përballet me sfidat më të mëdha që është përballur ndonjë lider i Kremlinit prej kur Mikhail Gorbachev u ballafaqua

me rënien e Bashkimit Sovjetik para më shumë se tri dekadave. Lufta në Ukrainë e ka nxitur konfrontimin më të madh me Perëndimin prej se ndodhi Kriza e Raketave Kubane më 1992; sanksionet e Perëndimit e kanë shkaktuar tronditjen më të

madhe të brendshme ndaj ekonomisë ruse në dekadat e fundit; dhe Putini është përballur me një kryengritje të dështuar nga mercenari më i fuqishëm i Rusisë, Yevgeny Prigozhin, në qershor. Prigozhini u vra si pasojë e rrëzimit të avionit dy muaj pas kryengritjes. Perëndimi e paraqet Putinin si një kriminel luftime dhe diktator i cili e shndërroi Rusinë në vend imperialist dhe uzurpues të tokave, duke e dobësuar Rusinë dhe duke e forcuar shtetësisë e Ukrainës dhe në të njëjtën kohë, duke e bashkuar Perëndimin dhe duke i dhënë mision NATO-s. Putini, megjithatë, e paraqet luftën si pjesë të një lufte më të gjerë me Shtetet e Bashkuara, për të cilat Kremlini thotë se synojnë ta ndajnë në dysh Rusinë.

ISH-AMBASADORI I KOSOVËS NË MAQEDONINË E VERIUT, GJERGJ DEDAJ,
KA FILLUAR DËSHMINË NË GJYKATËN SPECIALE

Dedaj thotë se nuk është maltretuar nga UÇK-ja: Ajo bëri realitet lirinë e Kosovës

Ish-ambasadori Gjergj Dedaj ka filluar të hënën dëshminë në Gjykatën Speciale në Hagë. Dedaj para trupit gjykues në rastin e liderëve të UÇK-së ka mohuar kategorikisht se është maltretuar nga UÇK-ja. Dedaj ka thënë se deklaratat që ka dhënë pas luftës lidhur me ndalimin e delegacionit të LDK-së nga UÇK-ja nuk reflektojnë realitetin. Ai ka deklaruar se gjatë ndalimit në Qirez në shtator të vitit 1998 nuk e ka parë Hashim Thaçin. Para trupit gjykues Dedaj ka treguar rastin e familjes, të cilit forcat serbe ia kishin vranë 12 anëtarë të familjes. Dedaj ka thënë se asnjëherë në jetë nuk do ta njollosë luftën titanike të UÇK-së

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, 6 NËNTOR - Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka filluar dëshminë në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Gjykatën Speciale në Hagë.

Dedaj të hënën është marrë në pyetje nga prokurori i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS). Ai gjatë dëshmisë së tij ka mohuar se është maltretuar ose rrahur nga pjesëtarë të UÇK-së gjatë një ndalimi në fshatin Qirez të Skenderajt. Po ashtu, Dedaj ka thënë se deklaratat që i ka dhënë më herët për rastin e Qirezit dhe Baicës janë të pasakta për shkak se nuk ka qenë mirë emocionalisht. Dedaj ka thënë se asnjëherë në jetë nuk do ta njollosë luftën titanike të UÇK-së. Ai ka thënë para trupit gjykues se asnjëherë nuk ka pasur probleme me UÇK-në, por me Serbinë, e cila ia ka vranë 12 anëtarë të familjes.

UÇK-ja nuk na ndaloi gjatë vizitës në Qirez

Dëshmitari Gjergj Dedaj ka thënë se gjatë vizitës në Qirez në vitin 1998 nuk janë ndaluar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Ai ka thënë se nuk kanë pasur fare shqetësim nga pjesëtarët e UÇK-së dhe se shqetësimi i tyre ishte gjendja e popullatës civile atje. "Ishte një makinë e cila kishte shenja, ndërsa detajet është problem m'i kujtu. Ne nuk e kishim fare shqetësimin nga pjesëtarët e UÇK-së. Shqetësimet tona ishin për gjendjen e popullatës civile në ato zona dhe me të thënë të drejtën, kur e kemi parë UÇK-në, jemi gëzuar shumë dhe jemi ndierë krenarë", ka thënë Dedaj. Ai ka thënë se gjatë kësaj vizite kanë shkuar rreth 30-35 veta, me makina e kravata si në dasmë. "Ndoshta kemi qenë 10-12 deputetë, nuk e di saktë. Kanë qenë gazetarë, kanë qenë disa zonja. Kanë qenë shoferët sepse

ne kemi shkuar me kravata, me makina si në dasmë, dhe ju tregova pse kemi shkuar. Në Qirez kemi qenë 30-35 vetë, nuk e di saktë, sepse nuk dua të spekuloj", ka thënë Dedaj, duke treguar emrat e disa personave për të cilët kanë qenë pjesë e delegacionit. "Kam qenë kryetar i delegacionit. Ka qenë zonja Nekibe Kelmendi si zëvendëse e kryetarit të delegacionit, një zonjë të cilën më vonë serbët ia kanë vranë burrin dhe dy djemtë. Mua m'i kanë vra 12. Kanë qenë edhe deputetë të tjerë Isuf Telaku, Agim Krasniqi, Hasim Dërmaku, Sokol Blakaj, Agim Krasniqi, Mehdi Bardhi...", ka thënë ai.

Dedaj ka përshkruar edhe veprimet që ai dhe delegacioni i kishin ndërmarrë gjatë vizitës në Qirez. "Në hyrje të Qirezit kemi parë pjesëtarë të UÇK-së. Fillimisht kam shkuar në xhaminë e fshatit, e cila, me sa me kujtohet, ka qenë e bombarduar nga forcat serbe dhe kam vizituar popullatën civile, të sëmurit, fëmijët të cilët ishin në atë xhami në gjendje të papërshkrueshme, në gjendje tmerruese në gjendje trishtimi. Kemi vizituar edhe shkollën, pastaj kemi vizituar një zyrë e cila thoshin se është Zyra për Informim e Qendrës së LDK-së, kemi hyrë brenda për t'i pyetur banorët për situatën në Qirez", ka thënë Dedaj. Më tutje, Dedaj ka folur lidhur me vizitat që delegacioni politik i ka bërë në zonat e luftës.

Dedaj në dëshminë e tij ka mohuar se e ka parë Hashim Thaçin në Qirez. "Nuk e kam parë kurrë në jetën time. As në Prishtinë e as në Qirez, tek e kam parë në Baicë pas 2-3 orëve që ka ndodhur ai rast", ka thënë Dedaj, duke treguar se çfarë kishte ndodhur në takimin që kishin pasur me pjesëtarët e UÇK-së në Qirez.

Dedaj është pyetur nga prokurorja edhe për Rexhep Selimin për të cilin Dedaj ka thënë se e ka takuar në Baicë, i cili, sipas tij, është sjellë në mënyrë korrekte me të dhe të



tjerët.

Gjatë dëshmisë së tij dëshmitari Gjergj Dedaj ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar gjatë marrjes në pyetje kanë dashur të nxjerrin elemente fajësuese për UÇK-në. Dedaj ka thënë se i është dashur që t'i sigurohej një avokat ose këshilltar juridik për t'i sqaruar gjërat dhe, sipas tij, ZPS-ja ka qenë duke folur me një "kufomë të gjallë". "Unë kam qenë, në fakt, kufomë. Edhe sot jam kufomë. Kanë provuar me nxjerrë sa më shumë elemente fajësuese për UÇK-në, renduese e për çka nuk di unë", ka thënë Dedaj, por që është kundërshtuar nga prokurorja, e cila ka thënë se nga ajo që sheh në dokumentin e prezantuar është se dëshmitari është këshilluar nëse ka nevojë për ndonjë avokat.

Pas kësaj, Dedaj ka thënë se gjithmonë do ta thotë të vërtetën pa marrë parasysh çmimin. "Gjithmonë e them të vërtetën, pa marrë parasysh çmimin, dhe nuk më kujtohet që më kanë dhënë këshilla të tilla dhe jam brengos se në çfarë gjendje shpirtërore, familjare, emocionale, domethënë duke mbledh kufoma, trupa të djegur, më kanë marrë në pyetje, që unë konsideroj që është një shkelje e të drejtave të njeriut", ka thënë Dedaj.

"90 për qind të deklaratave që i kam dhënë pas luftës nuk kam qenë normal"

Gjergj Dedaj ka thënë se deklaratat që ka dhënë pas luftës lidhur me ndalimin e delegacionit të LDK-së "nuk ka qenë normal". "Më kanë marrë në pyetje kur unë kam pritur

kufoma familjarët. Konsideroj se kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. 90 për qind të deklaratave pas lufte nuk kam qenë normal, në gjendje me i thënë të vërteta. Jam i gatshëm për t'u ballafaquar me çdo gjë. Edhe sot jam kufomë pa asnjë vlerë. Nuk e di pse jam gjallë. Asnjëherë nuk do ta njollos ushtrinë titanike, epike, ndër më të pastrat, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)", ka thënë Dedaj.

Partitë politike në Prishtinë e kishin shikuar me xhelozzi UÇK-në

Gjergj Dedaj në dëshminë e tij ka përshkruar raportet që Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) ka pasur me partitë politike shqiptare në Prishtinë gjatë kohës së luftës. Dedaj ka thënë se forca politike në Prishtinë e ka shikuar me xhelozzi UÇK-në. "UÇK-ja që nga shfaqja e saj e parë publike më 28 nëntor '97 në varrimin e mësuesit Halit Geci në Llaushë domethënë është shikuar me rezervë, por ajo filloi të rritej, të hapej dhe të gëzonte respekt gjithandej Kosovës dhe forcat politike në Prishtinë e kemi shikuar me xhelozzi", ka thënë Dedaj.

I pyetur se a ka pasur tensione në mes të UÇK-së dhe forcës politike në Prishtinë, Dedaj ka thënë se ka pasur moskordinim. "Partitë politike në Prishtinë e kanë shikuar me drojë dhe më shumë shqetësim shfaqjen e UÇK-së, kësaj guerile që, në fakt, doli ta bëjë realitet lirinë e Kosovës. Ka pas edhe individë në parti që kanë bërë dezinformata kundër UÇK-së dhe unë kam pas dëshirë të shkoj vetë në ato zona duke rrezikuar jetën tonë", ka thënë Dedaj.

Dedaj në Gjykatën Speciale: Kam lëndim në zemër, Serbia m'i ka vranë 12 anëtarë të familjes

Ish-ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, në Gjykatën Speciale është pyetur se çfarë mendon për ish-presidentin Ibrahim Rugova. Ai ka thënë se Rugova ka qenë themelues i shtetit të Kosovës, kurse ish-presidenti tjetër, Hashim Thaçi, sipas tij, e ka përmblytur procesin e pavarësisë. "Presidenti Rugova është themelues i shtetit të Kosovës, ndërsa lideri Hashim Thaçi e ka përmblytur procesin e pavarësisë së Kosovës", ka thënë ai.

Dedaj është pyetur edhe për karrierën politike të tij. Në hyrje të dëshmisë së tij, Dedaj është pyetur për rolin dhe pozitën që ka pasur në Kosovë. Ai nuk ka lënë pa përmendur shkarkimin e tij nga pozita e ambasadorit në Maqedoninë e Veriut nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani. Bile ai është treguar i ashpër te kjo pjesë, duke thënë se është larguar dhunshëm dhe brutalisht nga pozita e ambasadorit. "Në vitin 2004 kam fituar ulëse në Kuvendin e Kosovës. Kam qenë zëvendësministër në disa dikastere. Zëvendësministër i Jashtëm. Së fundmi kam qenë ambasador i Republikës së Kosovës. Jam larguar dhunshëm dhe brutalisht nga e ashtuquajtura presidente Osmani për qëllime politike sepse në vend timin e ka dërguar burrin e saj", ka thënë Dedaj.



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ
CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (7)

Masakrimi i pleqve me sëpata

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së shtatë, flet se si forcat serbe në vitin 1999 kanë hyrë në shtëpitë e shqiptarëve duke masakruar pleq me sëpata. "Banorët që nuk kishin mundur të largoheshin nga fshati u detyruan të futeshin në shtëpi të padëmtuara dhe aty u ekzekutuan", ka theksuar Bardhyl Mahmuti

Prishtinë, 6 nëntor -

"Epoka e re": Pas përfundimit të luftës është përfolur se në vrasjen e Enver Malokut ka qenë i përfshirë edhe inspektori i lartë i Sigurimit Shtetëror të Serbisë, i përkatësisë etnike shqiptare, Lutfi Ajazi.

Bardhyl Mahmuti: Po! Për të është thënë se ka qenë i përfshirë edhe në vrasje dhe krime të tjera. Madje, me sa më kujtohet, është thënë se ky kriminel ka marrë pjesë edhe në tentim-vrasjen e njërit nga themeluesit e LDK-së, intelektualit Sabri Hamiti, më 24 shtator 1998. Fatmirësisht Sabri Hamiti u shpëtoi plagëve që kishte marrë në atentatin kundër tij. Nuk mund ta di saktësisht në cilat krime kanë qenë të

përfshirë drejtpërsëdrejti Selim Broshaj, Ibush Kllokoqi, Lutfi Ajazi, Ajet Istogu, Jakup Hoti, Nazim Bllaca dhe bashkëpunëtorët e tjerë të okupatorëve serbë me origjinë shqiptare, por mund ta them me bindje të plotë se asnjë vrasje e kësaj natyre nuk është bërë me urdhër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Personalitete të larta politike që kanë pasur funksione të larta shtetërore e pohojnë publikisht se urdhërdhënës për kryerjen e këtyre krimeve ka qenë Shtabi Strategjik i Sllobodan Millosheviqit, zbatues i urdhrit ka qenë Shërbimi Sekret i Serbisë, ndërsa ekzekutues kanë qenë kriminelë të përkatësive të ndryshme etnike.

Do të përmend vetëm edhe një

rast nga rastet e shumta të vrasjeve të intelektualëve dhe veprimtarëve politikë. Më 21 shkurt 1999, para shtëpisë së vet në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit, u ekzekutua nga forcat e armatosura serbe veprimtari i njohur shqiptar, Gafurr Loku dhe djali i tij, Dritoni (20 vjeç). Që nga viti 1971, kur ishte student në Universitetin e

Prishtinës, e deri në vrasjen e tij, në vitin 1999, Gafurr Loku ka qenë vazhdimisht i përndjekur nga regjimet e njëpasnjëshme jugosllave. Më 21 janar 1973 Gjykata e Qarkut në Shkup e dënoi me 5 vjet burg për shkak të angazhimit për avancimin e të drejtave të shqiptarëve, ndërsa më 16 gusht 1982, e njëjta gjykatë e dënoi me 3 vite e 6 muaj burg. Për të fshehur përgjegjësinë shtetërore të Serbisë në kryerjen e këtij krimi, në botimin e vitit 2001 të "Librit të bardhë", Gafurr dhe Driton Loku përfshihen në listën e "të vrarëve nga terroristët shqiptarë".

"Epoka e re": Kur flitet për vrasjen e intelektualëve dhe të veprimtarëve politikë, në librin "Mashtrimi i madh" dhe në disa shkrime autoriale, ju i cilësoni si vrasje të dyfishta. Përse ky kualifikim?

Bardhyl Mahmuti: Ekzekutimi i intelektualëve dhe veprimtarëve politikë me urdhër të Shtabit Strategjik të Millosheviqit është vrasje e dyfishtë, sepse, përveç vrasjes së tyre fizike, shpallja nga shteti serb e Fehmi Aganit, Enver Malokut, Gafurr Lokut, Agim Hajrizit, Latif Berishës, Bajram Kelmendit, Xhemajl Mustafës dhe

134. ЉОКИ ГАФУР, из Паливоденице, општина Качаник, рођен 11.08.1949. године у Паливоденици, од оца Џафера. Убили су га албански терористи 21.02.1999. око 19,50 сати, из аутоматског оружја испред његове куће у наведеном селу, заједно са сином Дритоном (доказ: 602/99-11, 83/00-896, 288/00-5).

135. ЉОКИ ДРИТОН, из села Паливоденица, општина Качаник, рођен 30.06.1979. године у Бенерал Јанковићу, од оца Гафура. Убили су га албански терористи заједно са оцем 21.02.1999. око 19,50 сати, испред њихове породичне куће (доказ: 602/99-11, 83/00-896, 288/00-5).

shumë veprimtarëve të tjerë të çështjes kombëtare se goja ishin “shqiptarë besnikë ndaj Republikës së Serbisë, të vrarë nga UÇK-ja”, është përpjekje për të përdhosur dhe vrarë edhe veprimtarinë e tyre për çlirimin e Kosovës. Madje vrasje të dyfishtë i kualifikoj të gjitha krimet që janë bërë me urdhër të strukturave shtetërore serbe në funksion të prezantimit të UÇK-së si organizatë terroriste, sepse kjo mënyrë e fshehjes së krimet përdhos kujtimin e të gjitha atyre viktimave të gjenocidit në Kosovë që janë përfshirë në këto lista.

“Epoka e re”: Përveç intelektualëve dhe veprimtarëve politikë të vrarë me urdhër të Shtabit Strategjik të Millosheviqit, që u përfshinë në listat e “civilëve të vrarë nga UÇK-ja”, në listat e përpiluara për viktimat e luftës në Kosovë, Shërbimi Sekret i Serbisë ka renditur emra të një numri të konsiderueshëm civilësh që nuk kishin të bënin as me fushën intelektuale, as me veprimtarinë politike. Cilin rast nga kjo kategori e civilëve do ta veçoni?

Bardhyl Mahmuti: Për lexuesit do të përzgjedh një pjesë të listës së civilëve të vrarë, të cilët propaganda serbe i ka prezantua si “shqiptarëve besnikë ndaj Republikës së Serbisë, të vrarë nga terroristët shqiptarë.”

fshatin Llashticë dhe vranë Ali Selimin, Enver Murselin, Ymer Rashitin, Lulzim Musliun, Rukije Ramushin, Habibe Ramushin, Nezir Ramushin, Xhyzide Hasanin dhe Lirim Shabanin. Gjatë këtij operacioni u dogjën 123 shtëpi, 137 objekte ndihmëse, shkolla dhe biblioteka e fshatit. Në të njëjtin kohë forcat serbe plaçkitën 90 traktorë, 120 moto-kultivatorë, 3 autokombajna, 3 kombibusa, një kamion, 130 vetura dhe 680 kafshë.

Dy javë më vonë, më 30 prill 1999, filloi akti i dytë i tragjedisë: fshati u bombardua nga të katër anët. Banorët që nuk kishin mundur të largoheshin nga fshati u detyruan të futeshin në shtëpi të padëmtuara dhe aty u ekzekutuan: Hysen Hyseni, Ajshe Hyseni, Fazli Hyseni, Arife Hyseni, Driton Hyseni, Mirije Hyseni, Blerim Halili, Rifat Shabani, Selami Shabani, Zijavere Shabani, Fisnik Shabani, Sylejman Ibishi dhe Xhavit Berisha. Me qëllim që të humbin gjurmët e këtij akti gjenocidi, shtëpisë dhe kufomave ua vunë zjarrin. Megjithatë nëpër zjarr dhe tym të shtëpive dhe të kufomave që digjeshin, të plagosur rëndë sa edhe forcat serbe i morën për të vdekur, arritën të shpëtojnë Vlora Shabani, Deli Hyseni, Drita Hyseni, Ymer Ibishi dhe Nehat Shabani.

Vlora Shabani, kjo vajzë 13 vjeçare të cilën propaganda serbe e prezantonte me emrat Fljora Shabani dhe Flore Shabani, nuk kishte vdekur! Ajo u mbijetoi plagëve dhe është dëshmitare e gjallë e tmerrit kur iu vranë, në praninë e saj, babai, Selamiu (mësues i fshatit), nëna Zijaverja, vëllai, Fisniku, që ishte vetëm 3 vjeçar, dhe gjyshi, Rifati.

Dëshmitë publike të Vlora Shabanit detyruan Shërbimin Sekret të Serbisë të hiqte emrat Fljora Shabani dhe Flore Shabani nga lista e publikuar në botimin e vitit 2001. Megjithatë botimi në gjuhën angleze (mars 2000) vazhdon të qarkullojë në qarqe të ndryshme politike dhe diplomatike ndërkombëtar duke mbajtur gjallë mundësinë që lexues të rinj të bien viktima të sajësive të Shërbimit Sekret të Serbisë.

“Epoka e re”: Për aq sa shihet nga vitet e lindjes, disa nga personat që përmenden në pjesën e shkoqitur nga lista e viktimave civile që i vishen UÇK-së janë persona në moshë. A keni pasur mundësi të hulumtoni për rrethanat e vrasjeve të tyre.

Bardhyl Mahmuti: Po! Do të jap disa të dhëna shkurtimisht. Në numrin rendor 264 është përfshirë Naxhije Bunjaku (Nadjija Bunjaku në transkriptimin anglisht), e moshës 72 vjeçare, e vrarë më 7 maj 1999, në Gjilan. Para agimit të ditës së 7 majit 1999, në 01:30, tre pjesëtarë të forcave të armatosura serbe (Predrag Jankovi, Dušan Panajotovi dhe Zoran Stevi), hynë në shtëpinë e familjes Bunjaku dhe kërkuan djalin e vetëm të kësaj familje, Shkëlzen Bunjakun. Naxhija u përpoq t'i pengonte që të mos hynin në dhomën ku ishin fëmijët e Shkëlzenit. Meqë nuk e gjetën Shkëlzenin, ata ekzekutuan nënën e tij.

Për të hequr përgjegjësinë nga shteti për vrasjen e një gruaje të moshuar, kjo vrasje u regjistrua në Prokurorinë e Gjilanit, më 15 maj 1999 (dosja KI. 13/99). Predrag Jankovi, Dušan Panajotovi dhe Zoran Stevi u arrestuan dhe kundër tyre u ngrit aktakuzë për veprën penale të vrasjes (Aktakuza PP.16/99).

Pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, askush nuk dha përgjegjësi për vrasjen e Naxhije Bunjaku dhe sot e kësaj dite emri i saj figuron në listat e civilëve të vrarë që i vishen UÇK-së. Në numrin rendor 265 kemi Ahmet Kokollarin, 74 vjeç, i ekzekutuar nga forcat serbe në shtëpinë tij. Është tepër tragjike rasti i vëllezërve Hasan Ademi, 90 vjeç

ishte nga fshati Sodovinë e Jerlive e Komunës së Vitisë, siç e prezanton propaganda serbe, por nga fshati Vërban i kësaj komune.

“Epoka e re”: Si e shpjegoni që në pjesën ku vrasja e Fehmi Aganit i vishet UÇK-së përmendet si i vrarë edhe Ahmet Isufi, i cili jo vetëm që nuk ka qenë udhëheqës i FARK-ut, por ende është gjallë.

Bardhyl Mahmuti: Përveç “vrasjes” së veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Ahmet Isufit, në kumtesën e datës 7 maj 1999 lidhur me vrasjen e Fehmi Aganit, Policia serbe shpalli se goja “UÇK-ja kishte vrarë edhe poetin, Din Mehmeti dhe shkrimtarin, Teki Dervishi.

Lipljana. Srpska vlast tvrdila je da je Aganija ubio OVK kako bi spriječio pregovore između Rugove i srpskih vlasti. Izvještaj policije od 7. maja 1999 glasi:

Pretpostavlja se da su teroristi takozvanog OVK-a držali Aganija u izolaciji da bi spriječili njegovu mješanje u pregovore između Ibrahima Rugove i Vlade Republike Srbije. Kada je Rugova otišao za Rim, nisu više imali razloga da ga zadrže, pa su ga ubili. Ovaj najnoviji teroristički akt može se nesumnjivo protumačiti kao potvrda već najavljene odluke OVK-a da bi slično postupili i sa gospodinom Ibrahimom Rugovom.

U izvještajima stoji da su ostali istaknuti pojedinci, poput Latifa Berishe, predsjednika DSK-a u Kosovskoj Mitrovici, pjesnika Dina Mehmetija, pisca Tekija Dervishija takode ubijeni. Dana 24.

dhe Ismajl Ademi, 83 vjeç, dhe i gruas së Ismajlit, Fatimja, 81 vjeçe, nga fshati Koshare e Ferizajt. Fatimja ishte e paralizuar dhe nuk kishin pasur asnjë mundësi transporti të largohesh nga fshati. Dy pleqtë (Hasani dhe Ismajli) mbetën të përkujdeseshin për Fatimen. Më 14 maj 1999 forcat serbe hynë në shtëpinë e tyre. Për të “kursyer” plumbat, Hasanin, Ismajlin dhe Fatimen i masakruan me sëpata. Në fund, Shërbimi Sekret i Serbisë i përfshiu në numrat 266, 267 dhe 268 në listën e “viktimave civile të vrarë nga terroristët shqiptarë”.

Rrahim Rrahmani, 71 vjeç, u vra para shtëpisë së tij gjatë operacioneve për spastrimin etnik të Kosovës. Ky person nuk

Një shprehje popullore në Kosovë thotë: “Çka ka shtëpia / Kallëzon fëmija!” Ahmet Isufi, Din Mehmeti dhe Teki Dervishi janë vetëm tre personalitete nga qindra intelektualë dhe veprimtarë të çështjes kombëtare që ishin paraparë të vriteshin nga Serbia dhe për vrasjen e tyre të fajësohej UÇK-ja. Fatmirësisht Ahmet Isufi është ende gjallë dhe është duke dhënë kontribut të çmueshëm në skenën politike, ndërsa Din Mehmeti dhe Teki Dervishi patën fatin t'i shpëtonin planit për likuidimin e tyre dhe të shohin Kosovën e lirë! (Din Mehmeti vdiq më 12 nëntor 2010, ndërsa Teki Dervishi më 29 qershor 2011).

“Epoka e re”: Sado absurde të duken akuzat e tilla, fatkeqësisht, nuk kanë mbetur pa efekt.

Bardhyl Mahmuti: Përpiluesit e listave të tilla dhe shpërndarja në qarqet politike, diplomatike dhe të mediave ndërkombëtare janë nisur nga parimi se janë të pakta gjasat që lexuesit e huaj të jenë të informuar për identitetin e cilitdo qoftë nga civilët e vrarë që figurojnë në këto listë. Për shumicën absolute të lexuesve të këtyre listave, emrat janë të panjohur, siç janë të panjohura edhe rrethanat e vrasjeve të tyre. Nuk flas vetëm për lexuesit e jashtëm. Nëse do të bënim një sondazh rreth kësaj çështjeje dhe të përzgjidhnim popullatën e anketuar nga anëtarë të organeve drejtuese të partive politike shqiptare në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginë të Preshevës, nga deputetë, ministra, diplomatë, historian dhe gazetarë shqiptarë, rezultatet do të na befasonin për keq!

(Muhamet Mauraj / Vijon)

261. Fljora Šabani from the village of Vlaštica (Gnjilane). Killed on 1 May 1999 in this village
262. Flore Šabani from the village of Vlaštica (Gnjilane). Killed on 1 May 1999 in this village
263. Flore Šabani from the village of Vlaštica (Gnjilane). She was killed on 1 May 1999 in this village
264. Nadjija Bunjaku (1927) – from Gnjilane. Killed on 7 May 1999 at about 01:30 a.m. in Gnjilane
265. Ahmet Kokolari (1925) – from Štimlje. Killed on 10 May 1999 in Štimlje at his house.
266. Ismailj Ademi (1916) – from the village of Košare (Uroševac). Killed on 14 May 1999 at his home, together with his wife, Fatima.
267. Fatima Ademi (1918) – from the village of Košare (Uroševac). Killed on 14 May 1999 at her home, together with her husband Ismailj.
268. Hasan Ademi (1909) – from the village of Košare (Uroševac). Killed on 14 May 1999 at his home together with Ismailj and Fatima Ademi.
269. Rahim Rahmoni (1928) – from the village of Jerli Sadovina (Vitina). Killed on 16 May 1999 at about 12:50 p.m. in this village.

Në numrin rendor 261 të kësaj liste kemi personin me emër Fljora Shabani nga fshati Vlaštica, emri në gjuhën serbe për fshatin Llashticë të komunës së Gjilanit, ndërsa në numrat rendor 262 dhe 263 përsëritet dy herë emri Flore Shabani. Përveç datës së vrasjes (1 maj 1999) dhe se janë nga fshati Vlaštica (Llashticë), nuk jepet asnjë e dhënë rreth moshës së këtyre “tre” personave!!! Çdo lexues i vëmendshëm i kësaj liste do të vërente se diçka nuk ishte në rregull me tre emrat gati identik të tre personave nga i njëjti vendbanim, të vrarë në të njëjtën ditë, në të njëjtin vend! Po e sqarojmë për lexuesin se në Kosovë ka vetëm një fshat që mban toponimin Llashticë (Vlaštica). Kushdo qoftë që ka qenë i interesuar të informohet rreth së vërtetës për këta tre emra, ka mësuar për tragjedinë që kishin përjetuar banorët e këtij fshati. Më 13 prill 1999 forcat e armatosura serbe sulmuan



Vlora Shabani, e mbijetuara e gjenocidit në fshatin Llashticë, me njërin nga plagët që shihet në fytyrën e saj (në mollëzën e majtë).

Abdixhiku tregon se "Termokos"-i ka marrë ndihmë nga komuna e Prishtinës 5 milionë euro

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se me iniciativën e asamblistëve të LDK-së në Prishtinë dhe aksionarëve të tyre në ndërmarrje, "Termokos"-i këtë javë ka marrë ndihmë kapitale nga komuna e Prishtinës prej 5 milionë

eurosh. Ai ka thënë se me këto mjete sot një vit ngrohje qendrore do të kenë banesat e bardha në "Bregun e Diellit" në plot 65 mijë metra katrorë banim. "Një zotim elektorale ky. Lagjja Lakrishtë me plot 500 mijë metra katror banim e afarizëm. Lagjja Kalabria me 68 mijë metra katror

banim. Përveç këtyre, ngrohje qendrore do të kenë dhe ushtarët tanë në Kazermën Ushtarake 'Adem Jashari'; Arkivi i Prishtinës, 3 shkolla e 3 xhami në Qytetin e Vjetër të Prishtinës. Në ndërkohë, në pritje të zhblokimit politik të Rrugës A", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".



Latifi: Komandantët Toni e Mici me shokë ishin viganë të luftës së popullit shqiptar për çlirimin e Kosovës

RAHOVEC, 6 NËNTOR - Në 25-vjetorin e rënies në përballje me forcat pushtuese serbe, kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me familjarë të dëshmorëve, bashkëpunëtorë e bashkëluftëtarë, kanë nderuar kujtimin dhe veprën e pavdekshme ndër breza të heronjve Xhelal Hajda - Toni, Selajdin Mullabazi - Mici nga Rahoveci, Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Ymeri nga Vushtrria. "Luftëtarët, komandantë të luftës çlirimtare, janë heronjtë që mbajnë mbi kokë aureolën e lavdisë, duke u bërë shembëlltë për brezat. Ata vazhdojnë të na frymëzojnë edhe sot e mot. Gjaku i Tonit e Micit, i

Hamdiut, Bekteshit e Nezirit, nuk do të tretet e as nuk do të thahet dhe përmendoret e statujat e tyre sikur flasin pa nda me ne. Ata u bënë piketa orientuese për ardhmëri. Arritjet e mëdha kërkojnë fljime të mëdha dhe komandantët Toni e Mici me shokë, qenë viganë të luftës së popullit shqiptar për çlirimin e Kosovës, nën emblemën e UÇK-së. Pa këtë luftë dhe pa këto rënie të mëdha ne nuk do të ishim në gjendje të dimë çfarë vlere ka liria. Dëshmorët e treguan me vepra dashurinë e tyre, duke dhënë jetën dhe neve na takon ta dëshmojmë dashurinë ndaj vendit me punë e përkushtime të përditshme", është shprehur Latifi.



250 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të Mitrovicës morën pjesë në 'Krosi vjeshtor - Mitrovica 2023'



MITROVICË, 6 NËNTOR - 250 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga komuna e Mitrovicës kanë marrë pjesë në aktivitetin sportiv "Krosi vjeshtor - Mitrovica 2023". Aktiviteti i parë masiv për këtë vit shkollor u organizua nga DKA Mitrovicë, dhe mësimdhënësit e edukimit fizik nga shkollat fillore dhe të mesme nga komuna e Mitrovicës. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin nënkryetari i

komunës, Arian Tahiri dhe drejtoresha e DKA-së, Drita Kadriu.

Krosi u organizua në rrugën paralel me lumin Ibër. Krosi u zhvillua në një atmosferë dhe frymë sportive. Ishte evidente prania e shumë nxënësve, mësimdhënësvë, drejtorë shkollash si dhe shumë qytetarë dhe entuziastë të sportit dhe adhurues të natyrës të cilët kishin

dalë të shijonin rrezet e diellit dhe bukuritë natyrore gjatë fundjavës. Në fund u zhvillua ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve - certifikatave dhe medaljeve për fituesit, organizatorët e Krosit - Mitrovica 2023 - falënderuan me këtë rast të gjithë nxënësit pjesëmarrës në këtë aktivitet, drejtuesit e shkollave pjesëmarrëse dhe mësuesit e edukimit fizik pjesëmarrës.

Kastrati: Duhet të punojmë së bashku për parandalimin e dukurive negative

MALISHEVË, 6 NËNTOR - Në kuadër të fushatës kombëtare për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, të hënën në Malishevë është mbajtur një takim me karakter vetëdijesimi me nxënësit, e ku morën pjesë edhe i pari i Malishevës, Ekrem Kastrati, përfaqësues të Ambasadës së ShBA-së në Kosovë, ICITAP, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSU),

Bashkësia Islame në Malishevë, shoqëria civile, përfaqësues të komunitetit RAE dhe të tjerë. Në hapjen e takimit i pari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka thënë se dukuritë negative, përfshi edhe trafikimin e qenieve njerëzore, duhet të luftohen në të gjitha mënyrat. "Dukuritë negative të cilat dëmtojnë shoqërinë duhet të luftohen nga të gjithë ne së bashku. Duhet të punojmë shumë dhe bashkërisht për një të ardhme të sigurt", ka

thënë kryetari Kastrati në fjalën e hapjes së takimit. Më pas, për qëllimin e kësaj fushate, për strategjinë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për rëndësinë e bashkëpunimit të komunitetit me organet përgjegjëse për luftimin e kësaj dukurie, kanë folur zyrtarët përgjegjës të Policisë së Kosovës, të EVSU-ve dhe të Ambasadës së ShBA-së dhe më pas është zhvilluar edhe një diskutim i hapur me nxënësit dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë takim.



Krasniqi viziton familjen e Isni Kilajt

MALISHEVË, 6 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, me kolegë dhe bashkëpunëtorë, ka vizituar familjen e Isni Kilajt në Lubizhdë të

Malishevës, i cili nga 2 nëntori është duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit në Hagë. "Liria popullit tonë nuk i është falur, por është fituar me gjak e sakrificë, andaj lufta e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës ka qenë e pashmangshme, por edhe e pastër. Tendencat për ta njollosur atë dhe çlirimtarët tanë - nuk do të kenë sukses. Drejtësia do të triumfojë!", ka njoftuar PDK-ja.



IKShPK-ja: Ende ka vlera të larta të manganitit në ujin e liqenit të Badocit

Prishtinë, 6 nëntor - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se është duke vazhduar përcjellja në vazhdimësi e cilësisë së ujit në liqenin akumulues të Badocit, të destinuar për pije dhe se nuk ka vend për panik. Sipas njoftimit të IKShPK-së, analizat e fundit laboratorike tregojnë ende vlera më të larta se niveli maksimal i lejuar i manganitit në ujin e liqenit dhe në rrjetin shpërndarës, sipas standardeve të parapara në Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021 - Cilësia e Ujit për konsum nga njeriu. "Ekipet e IKShPK-së janë në terren 24/7 dhe po bëhen çdo ditë analiza

fiziko-kimike të ujit të prodhuar në Fabrikën që furnizohet nga Liqeni akumulues i Badocit dhe qytetarët do të njoftohen me kohë për normalizimin e parametrevë referent të ujit të pijshëm. IKShPK-ja apelon qytetarët të cilët furnizohen nga fabrika e ujit në liqenin e Badocit se uji mund të përdoret për pastrim, mirëmbajtje të higjienës dhe ambienteve të banimit si dhe për nevoja të tjera. Uji në rajonet që furnizohen nga liqet akumulues Batllava dhe Ujmani mund të përdoren për pije pa përkufizim. Shpëlarja e rezervuarëve të ujit në shtëpi dhe ndërtesat e banimit të



përbashkët me qëllim pastrimi të Manganitit të shtresuar (përgjegjësi e amvisërive dhe këshillave të banimit)", ka njoftuar IKShPK-ja. Ky institut ka njoftuar se bashkëpunimi IKShPK/QU dhe KRU-ve me institucionet shtetërore është deri në qetësimin e situatës. "Po vazhdon bashkëpunimi i IKShPK-së me KRU 'Prishtina' deri në normalizimin e vlerave të manganitit. I bëhet thirrje popullatës që lidhur me këtë çështje t'u referohet vetëm njoftimeve zyrtare të këtyre dy institucioneve", ka njoftuar IKShPK-ja.

Berisha shpërfill vendimin e gjykatës, nuk paraqitet në policinë gjyqësore

Tiranë, 6 nëntor - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka shpërfillur të hënën vendimin e Gjykatës së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, sipas të cilit, ai do të duhej të paraqitej pranë një oficeri të policisë gjyqësore. Në kuadër të hetimeve ndaj procedurave për privatizimin e ish-kompleksit sportiv "Partizani", me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, gjykata ka vendosur ndaj tij masën e sigurisë "Detyrim për paraqitje", të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, si dhe "Ndalimin për të dalë jashtë vendit".

Në orën 10.00, kur do të duhej të paraqitej në policinë gjyqësore, Berisha u shfaq në dyert e parlamentit. Ai ka thënë se nuk kishte asnjë njoftim për vendimin e gjykatës, i cili, sipas tij, "duhet të shkojë në parlament, se aty e kam qendrën e punësimit, se në parti politike nuk vjen dot. Por atje nuk e



dërgojnë dot se ai vendim është shkelje flagrante e Kushtetutës". Pavarësisht se Berisha ka bërë ankimum ndaj vendimit të gjykatës, ai ka mbështetur që në fillim idenë se, sipas tij, masat e sigurisë janë në shkelje të Kushtetutës dhe se për to

do të duhej që të ishte kërkuar autorizim nga parlamenti. "Nuk mund të pranoj që Edi Rama me një grusht banditësh, që funksionojnë ose si grup i strukturuar kriminal, ose në forma të tjera në organet e drejtësisë, ta

shkelë Kushtetutën", ka thënë ai. Pritet të shihet se cili do të jetë qëndrimi i gjykatës ndaj refuzimit të ish-kryeministrit për ta zbatuar vendimin e saj. Kodi i Procedurës Penale parashikon që në një rast të tillë "Gjykata mund të vendosë një

masë tjetër më të rëndë". Në një rast të tillë, Prokurorisë do t'i duhej në mënyrë të pashmangshme që t'i kërkonte autorizim parlamentit, duke qenë se masa tjetër më e ashpër do të ishte "arrestimi në shtëpi". Ndaj Berishës nuk ka një akuzë. Ai dyshohet për "korrupsion" në bashkëpunim me dhëndrin e tij Jamarbër Mallezi, i cili është arrestuar. Masë sigurie ka dhe ndërtuesi Fatmir Bektashi, me të cilin Mallezi ishte ortak në ndërtimin e një kompleksi pallatesh mbi truallin e ish-klubit "Partizani".

Derisa i duhet të përballet me drejtësinë, Berisha dhe deputetët që e mbështesin kanë nisur protestat në parlament kundër shumicës të cilën e akuzojnë se po u refuzim të drejtën kushtetuese për ngritjen e komisioneve hetimore dhe se po përploqet ta përcaktojë përfaqësuesin e opozitës në komisionin e reformës zgjedhore.

Pronari i kompanisë "Baykar" viziton Kosovën pas blerjes së dronëve, dekorohet me medaljen "Shërbim të Shquar"

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, i shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe zëvendësministri Shemsi Syla, kanë pritur të hënën në takim pronarin e kompanisë "Baykar", Haluk Bayraktar, si dhe ambasadorin e Republikës së Turqisë, Sabri Tunç Angili. Ministri Maqedonci ka thënë se

bashkëpunimi me kompaninë "Baykar" është kthyer në kryefjalën e teknologjisë ushtarake dhe diskutoi për projektet e radhës në të cilat do të investohet, duke u pajtuar me Bayraktarin se ky bashkëpunim të zgjerohet përtej blerjeve. Ndërsa gjeneral Jashari në këtë takim u shpreh se përmes prodhimeve të blera nga kompania "Baykar", FSK-ja tani

mund ta ushtrojë misionin në nivelin që garanton mbrojtje territoriale dhe siguri. Për vullnetin e gatishmërinë që kjo kompani dhe Republika e Turqisë ka shfaqur për bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministri Maqedonci e dekoroi Bayraktarin me medaljen për "Shërbim të Shquar".



Kurti dhe Aliu promovojnë zvogëlimin e përdorimit të qeseve të plastikës

Prishtinë, 6 nëntor - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, kanë vizituar të hënën disa dyqane në qendër të Prishtinës. Kjo vizitë e tyre

është zhvilluar për ta promovuar zvogëlimin e qeseve të plastikës. "Bashkë me kryeministrin Kurti po e vazhdojmë informimin dhe ndërjegjësimin në dyqane, supermarkete dhe tregje për ndalimin e qeseve plastike

njëpërdorimëshe, për t'i informuar të gjithë qytetarët për udhëzimin e ri administrativ, njëherësh për t'u siguruar që po zbatohet legjislacioni i fundit ndaj zvogëlimit të përdorimit të qeseve të plastikës", ka thënë

ministri Aliu. Ndërkaq Kurti i ka falënderuar pronarët e marketeve për bashkëpunimin dhe i ka ftuar qytetarët të marrin torba me vete. Mandej ai tha se qeset pa doreza janë falas, ndërsa të tjerat 5 centë, e 2 centë prej



tyre do të shkojnë për buxhetin e shtetit.

Bizneset e grave që i udhëheqin burrat

PRISHTINË, 6 NËNTOR - "Gruaja është në shtëpi. Ajo është pronare e biznesit, por unë i shes drutë", këtë përgjigje mori "Radio Evropa e Lirë" nga një burrë pasi telefonoi në numrin e një biznesi, që në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) është i regjistruar me pronare grua. "Unë i shes drutë në një rren nga rrugët lokale të komunës së Prizrenit", tha ai.

"REL"-i telefonoi në dhjetë numra biznesesh që në ARBK figuron se udhëhiqen nga gratë. Prej tyre, gjashtë veta konfirmuan se bizneset e tyre udhëhiqen nga familjarët meshkuj, dy nga vetë gratë, ndërsa dy e ndërprejnë lidhjen pasi dëgjuan kërkesën e "REL"-it për të biseduar me pronaren e biznesit.

Bizneset që veçoi "REL"-i në listën e ARBK-së merren kryesisht me blegtori, bujqësi dhe tregti. "Po, merremi me blegtori. Unë jam pronare e biznesit, por ai menaxhohet nga burri dhe vjehri", tha një prej bashkëbisedueseve, duke shtuar se ka katër fëmijë dhe se nuk ka kohë t'u ndihmojë anëtarëve të tjerë të familjes.

Bisedat tregojnë se edhe bizneset e regjistruara me pronare gra - që janë dukshëm më pak se ato me pronarë burra - udhëhiqen në praktikë nga burrat.

Sipas një raporti të Institutit për Studime të Avancuara GAP në Kosovë, të publikuar në gusht, nga viti 2000 deri në vitin 2023 janë regjistruar gjithsej 227 759 biznese - 96 995 nga të cilat mbeten aktive. Prej tyre, 76 325 ose 78.7 për qind janë në pronësi të burrave, ndërsa 1 415 ose 18 për qind janë në pronësi të grave. Ato që udhëhiqen nga gratë, sipas GAP-it, janë kryesisht biznese mikro me nëntë ose më pak punonjës, ndërsa 1.5 për qind janë biznese të vogla me 10 deri në 49 punëtorë.

Të dhënat e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë për periudhën 2019-2023, që siguroi "REL"-i, tregojnë se numri i bizneseve të regjistruara me pronare gra, ka trend të rritjes. Nga viti 2019 deri në shtator të këtij viti në Kosovë



janë regjistruar 49 974 biznese të reja. Prej tyre, 12 801 janë biznese me pronare gra.

Pse disa biznese të grave i drejtojnë burrat?

"Kjo ndodh për shkak se në disa raste mekanizmat institucionalë i favorizojnë bizneset që drejtohen nga gratë - gjë të cilën ne e përkrahim", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Leonida Molliqaj, drejtoreshë ekzekutive e organizatës joqeveritare "QIKA". Sipas saj, favorizimet kanë të bëjnë me grante dhe subvencione që ndahen enkas për gratë, për t'i inkurajuar ato të angazhohen në ndërmarrësi. "Ne mendojmë se institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për ta verifikuar vërtetësinë e pronësisë së bizneseve", thotë Molliqaj. Mirlinda Kusari-Purrini, drejtoreshë ekzekutive e Shoqatës Afariste të Gruas "SHE-ERA", thotë se dukuria e

udhëheqjes së bizneseve të grave nga burrat është më e theksuar në viset rurale të Kosovës, sidomos në sektorin e agrokulturës. Këto, sipas saj, janë kryesisht biznese familjare që në punë i përfshijnë edhe gratë, por që në praktikë udhëhiqen nga burrat. "...sepse nëse aplikon për ndonjë grant qeveritar, ka pikë shtesë nëse biznesi është i regjistruar në emër të grave. Dhe, kështu, është i regjistruar në emër të tyre, por menaxhohet së bashku me burrat", thotë Kusari-Purrini.

"Radio Evropa e Lirë" pyeti në Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë se a ka mekanizëm që e verifikon udhëheqjen e bizneseve, por nuk mori përgjigje. Prishtina prin me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara në emër të grave, por përqindja më e lartë e tyre është në Pejë. Në Dragash më pak se 10 për qind e bizneseve janë të regjistruara në emër të grave,

ndërsa mbi 90 për qind janë të regjistruara në emër të burrave. Në programin e Qeverisë së Kosovës për vitet 2021-2025 thuhet se bizneset në pronësi të grave do të kenë "trajtim të veçantë". "Për ta mbështetur fuqizimin ekonomik të grave dhe rritjen e punësimit, me fokus në të bërit biznes, do të zbatojmë masa aktive për punësimin e grave dhe masa mbështetëse për sigurimin e likuiditetit për bizneset që udhëhiqen nga gratë", thuhet, mes të tjerash, në këtë program.

Në prill të këtij viti, në Javën e Pronësisë Industriale dhe Inovacionit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se gjatë qeverisjes së tij janë mbështetur 268 biznese - 40 për qind prej tyre në pronësi të grave - me vlerë prej 11.2 milionë eurosh.

Tregtia me shumicë dhe pakicë dominon bizneset e regjistruara në emër të grave në Kosovë. Në këtë sektor janë të regjistruara

mbi 4 700 të tilla.

Hamide Latifi, e cila me vite është marrë me trajnimin e grave për biznes përmes organizatës "Gratë në Biznes", thotë se subvencionet që ndahen për gratë në këtë fushë, janë kryesisht të mjaftueshme. Por, sipas saj, janë procedurat fillestare të zhvillimit të një biznesi ato që "i frikësojnë" gratë. "Dhe, për këtë arsye, iniciativat për regjistrim të bizneseve në emër të grave merren nga anëtarët e familjes burra", thotë Latifi për "Radion Evropa e Lirë". Ajo shton se shumë gra, pas një periudhe të shkurtër trajnimi, zotërojnë menaxhimin e kompanive të mëdha prodhuese.

Në rubrikën "Femina", "REL"-i ka sjellë rrëfimet e shumë grave në Kosovë që drejtojnë biznese nga më të ndryshmet.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të publikuara më 31 tetor, nga rreth 376 mijë të punësuar në Kosovë, mbi 142 mijë janë gra.

Nga 1 janari nuk mund të zhdoganohen veturat më të vjetra se viti 2014

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Nga 1 janar 2024 nuk mund të zhdoganohen veturat më të vjetra se viti 2014, ka bërë me

dije Dogana e Kosovës në një njoftim në "Facebook". Qeveria e Kosovës në vitin 2017 ka miratuar një ligj i cili thotë se

"mjettet rrugore që importohen në Kosovë nuk mund të jenë më të vjetra se 10 vjet". Mbështetësit e ligjit kanë thënë

në atë kohë se veturat e vjetra e ndotin ambientin, kryesisht përmes lirimit më të madh të gazrave.



RACIZMI I HAGËS DHE RACIZMI I PRISHTINËS



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Të dhunuar në Hagë, të përdhunuar në Prishtinë: Tash u mbushën tre vite të plota kur themeluesit e së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës që, në të njëjtën kohë ishin edhe bartësit e luftës çlirimtare, Hashim Thaçi, president i Kosovës, Jakup Krasniqi për dy mandate kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i PDK-së dhe Rexhep Selimi, kryetar i GP të Vetëvendosjes po mbahen në qendrën e paraburgimit në Hagë ndaj të cilëve ka filluar një proces maratonik gjyqësor ku i dihet data e fillimit por jo edhe ajo e përfundimit. Salih Mustafa u dënua me dënim drakonik e që të njëjtin fat e kishin Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Hysni Gucati tani u lirua me kusht kurse Nasimi vazhdon të dhunohet juridikisht për një vepër që përgjegjësinë kryesore e ka Gjykata Speciale Raciste që lëshoi në qarkullim materiale të ndjeshme që shërbyen si pretekst për pasurim të punonjësve të kësaj Gjykate duke kontrabanduar këto materiale, për arrestim të krerëve të Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së dhe përsheptim të arrestimit të krerëve të UÇK-së dha bartëse kryesore të institucioneve të shtetit të Kosovës. Është duke rrjedhur edhe gjyqi ndaj Pjetër Shalës sikur që lehtësisht mund të ndodhë të ketë proces edhe kundër Isni Kilajt që është i arrestuari i fundit i kësaj GJRS-së, deri në arrestimin e radhës. Se si është themeluar Gjykata Speciale Raciste, dihet nga ajo që ishte e qasshme në mjetet e informimit. Themelimi i kësaj gjykate nuk ishte me bërjen publike të raportit të Dik Martit por se ishte një këshillë, lexo urdhër i shteteve më të fuqishme që i parapriu këtij raporti kriminal të kriminelit Marti. Kishte presione diplomatike të ambasadorëve të shteteve të fuqishme që “garantonin” se e tëra kjo po bëhet për pastrimin e luftës së UÇK-së nga krimet e mundshme individuale. Një ambasadore thoshte publikisht se do të arrestohen 10 individë, jodomosdoshmërisht ushtarë të UÇK-së, një tjetër ambasador thoshte se do të arrestohen të dyshuar krejtësisht të parëndësishëm prandaj duhet të

pranohej që kjo gjykatë të themelohej. Dikush, si karrem e guajti rolin e Xhorxh Washingtonit të Amerikës që nënkuptonte se Xhorxh Washingtoni i Kosovës nuk do të arrestohej në asnjë rrethanë. Për të siguruar moskundërshtimin e shteteve, anëtare të Këshillit të Evropës si dyshim kyç e futën nxjerrjen e organeve nga të burgosurit (kryesisht serbë) dhe trafikimi i tyre që e paska bërë UÇK-ja në disa lokacione në Shqipëri. Ec e pas kësaj akuze kundërshtojë formimin e një komisioni hetues për të “gjeturat” e raportit të Dik Martit. Pastaj, gjërat shkuan “si vaji në tepsi” dhe votimi për themelimin të kësaj gjykate u shndërrua në çështje teknike. Dikush e votoi nga zori, të tjerët e votuan sepse kishin dorëzuar dosje edhe në Tribunalin e Hagës e pastaj edhe në Gjykatën Speciale Raciste. Këta ishin nga krahu i “paqes” ndryshe urrejtës patologjik të çdo gjëje që ka të bëjë me luftën e UÇK-së, ish të burgosurit politikë shqiptarë dhe me Bacën Adem Demaçi. Ndonëse janë raste për trajtim shëndetësor që duhet t’i nënshtrohen trajtimit të lirit nga urrejta patologjike, edhe sot e kësaj dite bartin poste të rëndësishme në qeverinë Kurti 2. Ishte një përpjekje sizifiane për ç’bërjen e kësaj gjykate e që u gjykua brutalisht nga ambasadorët e fuqishëm që kishin ushtruar shantazh të fuqishëm për themelimin e saj, siç e ceka më lart. Askush nuk shpresonte se LDK-ja do të votonte për ç’bërje të gjykatës sepse, po të ndodhte kjo është njësojë si ta mohojë veten tënde. LV-ja si opozitë e shrytëzoi për mrekulli situatën, botërisht e sulmonte gjykatën, praktikisht nuk bënte asgjë kundër saj. Përgjegjësi dhe detyrim politik për këtë nuk kishte sepse ishte opozitë kurse kombëtare e kishte vetëm si fasadë dhe mjet për të ardhur në pushtet. Në mesin e saj kishte ish-ushtarë të UÇK-së, dezertorë dhe ikës nga lufta që, për më keq kur ishin kapur nga Policia serbe kishin dhënë deklarata për UÇK-në (regjionin nga kishin ikur) më të forta se vet Nazim Bllaca. Kam fakte për këtë.

Adem Demaçi, Komandanti Politik që mbrojti UÇK-në: Baca Adem ishte këmbëngulës në mbrojtje të UÇK-së edhe para Gelbartit, edhe para Holbrukut edhe para sekretares Olbrajt, pa pyetur për çmimin që duhej paguar. E mbrojti edhe gjatë Konferencës së Rambujesë ndonëse kishte dhënë dorëheqje nga të qenit Përfaqësues Politik i Zyrës së UÇK-së në Prishtinë duke komunikuar për çdo ditë me anëtarët e delegacionit të krahu ushtarak në kohën kur paqësorët bënë shtatë

palë qejfe në këtë kështjellë duke kërkatë ushqime të paprovuara dhe pije për të cilat vetëm kishin lexuar se ekzistojnë. Baca nuk komunikonte fare as me krahu projugosllav dhe proserb të “përfaqësuesve” të shoqërisë civile, të pashmangshëm në të gjitha bisedimet për fatin e Kosovës, si informatorë të punëdhënësve të tyre! Baca Adem Demaçi fuqishëm ishte kundër Gjykatës Raciste Speciale sepse i dinte pasojat e saj. E mbronte fanatikisht luftën dhe bartësit e kësaj lufte, aktualisht pengje politike të kësaj gjykate. Këtë e bënte me bindje të plotë ndonëse nuk ishte fare në dashuri me disa prej tyre mirëpo mbizotëronte interesi i përgjithshëm. Para se të arsetoheshin, udhëheqësit më të lartë të UÇK-së dhe institucionalë të Kosovës ishin cak i një denigrimi publik nga një pjesë e LDK-së dhe nga pozita aktuale, pra LV-ja, bashkë me presidenten Vojsa Osmani. E luanin një lojë të Janusit; lufta e UÇK-së paska qenë e pastër ndërsa udhëheqësit e saj ishin kriminelë në kohën kur baballartët e kuadrit jugosllav dhe serbë të Vetëvendosjes e luftonin luftën e UÇK-së me të gjitha mjetet e mundshme dhe të pamundshme sikur që e bënin “pelegrinët” e misionarit të paqes, shtatorja e të cilit është para katedrales politike në obrorin dhe mbi themelet e gjimnazit më prestigjioz të kryeqytetit. Edhe kanë dërguar dosje në Gjykatë Speciale, edhe bëjnë homazhe në Prekaz, si bartës të posteve me rëndësi në Qeverinë e Kosovës. Sa të pafytyrë e sa të pamoralshëm që janë! Ndonëse po përballen me një gjykim që për një kohë të gjatë mund t’i lërë brenda, fushata denigruese ndaj tyre po vazhdon në disa binarë; publikisht duke i akuzuar si “shkatërrues të shtetit”, kurse në nëtokë e furnizojnë këtë gjykatë me dosje dhe “dëshmitarë të mbrojtur” në rrethana të një imoraliteti që nuk arsyetohet dhe nuk mbrohet me asgjë. Drejtësia ose padrejtësia tokësore është e rëndë, shkakton vuajtje dhe dhimbje por është e përbalueshme. Me kalimin e kohës kjo mund të ndryshohet, në dobi të të akuzuarit apo në dëm të tij. Ndërkaq, drejtësia hyjnore është e pamëshirshme, e noterizon drejtësinë apo padrejtësinë tokësore, pa të drejtë ankese. Këta që për model të sundimit e kanë zgjedhur urrejtjen midis njerëzve ku llaskucët dhe mjeranët shpërblehen për llaskucërinë dhe mjerimin ndaj sunduesve, pashmangshëm do të përballen me drejtësinë hyjnore, madje në çastet më të rënda për ta.

Sot po përballen me situata kur rrenës po i thonë e vërtetë, m.t i thonë mjaltë, mospërmbushjen e premtimit të dhënë po e përkthejnë si dëshitim i të tjerëve, dëshitim gjeneral po e mbulojnë me fatura të urrejtjes, me një fjalë; edhe po duan ta hanë piten edhe ta zhdukin tepsinë! Dikur thuhej se :“ të gjitha rrugët çojnë në Romë..” e që unë e përkthejë se gjuha e urrejtjes pashmangshëm do të përfundojë si dhunë , jo vetëm verbale. Më së paku verbale , në fakt! Të mbështetur me bythë kah duvari prapa të cilit i pret Hamilkari (i Serbisë e jo i Kartagenës) njohjen formale e kanë bërë si një kondom që moti ishte i grisur dhe i papërdorshëm ndonëse e kanë të qartë se me njohjen formale Max Velleri , si sponorisues imagjinari i saj , vetëm mund ta fshijë prapanicën. Pa mundësi riciklimi.

Është dallim i madh midis numrit 1 dhe numrit 10: Edhe vizitat që ua bënë në burgun e Hagës u bënë duke përzgjedhur , Rexhepin e vizitojmë sepse është i yni, Jakupin mbase e bëjmë për vete me përralla për kopalla kurse “ shkatërruesit e shtetit “ dhe kriminelët e luftës sipas pozitës aktuale nuk i vizitojmë . Për pushtetin që sot po sundon në Kosovë vetëm Hashimi dhe Kadriu janë “ persona non grata “ , i urrenjë më shumë se bashkëbiseduesin e Limozës , Radojiçiqin . Besnik Hiçmosgjëja vizitoi Rexhën kurse jo edhe Hashimin dhe Kadriun . Ashtu ishte direktiva e partisë. Kyremashtuesi i Kuvendit i vizitoi , jo në cilësinë e një vizite normale por si një bedel , pa koçë për vendimarrje. Edhe Liburnia ishte për vizitë. Nuk është gabim pse këta i vizitojnë por është gabim pse ata i pranojnë në vizita . Sepse po sjellin “ dhuratat e Danajit “ të luftës heleno – trojane . Presidentja Vojsa Osmani nuk shkonë sepse do të ndahet e papërmbushur nëse nuk dënohen siç e dëshiron. Edhe KM , gjithashtu nuk i viziton , nuk dëshiron të ndërhyjë në drejtësi . Për Rexhën pati dërguar garancione opozitare por jo edhe shtetërore. Që të katërt janë në të njëjtin kazan , Hashimi , Jakupi , Kadriu dhe Rexhepi , i pretë thuaja i njëjti vendim , o lirues ose dënues . Lotët për Rexhën që po derdhin disa në LVV -ë sot janë rrenë e shkuar rrenës . Ditën vajtojnë kine për shokun e tyre ndërsa natën urojnë që kur të mos kthehet . Mendësi tipike jugosllave , serbe dhe bizantine .

KM i Kosovës , zotëriu Albin Kurti vizitoi familjen e Rexhep Selimit dhe mirë bëri , si njeri dhe si kryeministër. KM i Kosovës ,

zotëriu Albin Kurti nuk vizitoi familjet e Hashim Thaçit , Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit . Në rrethana normale do të ishte shumë keq që nuk i vizitoi , në rrethana aktuale bëri shumë mirë që nuk i vizitoi për të evituar pasojat e , “ natën të vras , ditën të vajtojë .. “ .

Në përpjekje për ta lavdëruar fort Rexhep Selimin , driblloi fort familjen e Rexhës duke e vlerësuar pengun e Hagës me notën 10 –të (Rexha ishte 10 –shi i UÇK-së). Këtë e ndërldhi me notat në fakultetet tona ku nota 10 –të e ka peshën e notës dy në shkolla të një shteti me arsim normal.

Askush nuk mund ta mohojë faktin se Rexhep Selimi ishte 10 –shi i UÇK-së sikur që askush nuk mund ta mohojë faktin se Hashim Thaçi ishte 1 –shi i UÇK-së , 1-shi i shtetformimit dhe 1-shi i shpalljes së pavarësisë . Ishte 1-shi i të gjitha bisedimeve që kishin të bëjnë me luftën dhe paqen në Kosovës. Dikush e shkruan historinë , të tjerët e lexojnë . Hashim Thaçi , bashkë me Jakup Krasniqin , Kadri Veselin , Rexhep Selimin , Salih Mustafën , Hysni Gucatin , Nasim Haradinajn , Pjetër Shalën dhe Isni Kilajn po e shkruajnë një histori të re që do ia bashkangjesin asaj që e shkruan gjatë luftës së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës , historinë e mbrojtjes së fryteve të luftës së UÇK-së dhe të gjithë atyre që u martirizuan për këtë liri , qoftë duke e dhënë jetën apo duke qëndruar me dhjetra vite në llogoret e ish Jugosllavisë asnjëherë duke iu nënshtuar sunduesit , asnjë sunduesi , në të kaluarën por edhe tani.

Edhe Albin Kurti u bë 1-shi i qeverisë prandaj donë ta rishkruajë historinë e re të Kosovës . Për të mbetur edhe në të ardhmën 1-shi , historia duhet të fillojë nga koha kur Albin Kurti u bë 1 –shi. E pranueshme krejtësisht për llaskucët dhe mjeranët që e rrethojnë dhe të cilët , në momentin e parë kur më nuk do të kenë nevojë për Albin Kurtin , do ta tërheqin zvarrë duke e mohuar historinë e Kurtit dhe duke iu rikthyer historive tjera nga e cila do të përfitojnë. Shumë shpejt do të bindeni . Të qenit numër 1-ë , më shumë është barrë se përparësi , Albini po e provon në lëkurën e tij , më vonë edhe më shumë deri sa të mbetet lakuriq.

Një këshillë për pengjet e Hagës : nëse doni ta ruani qetësinë shpirtërore dhe mendore , mos hapni dyert për të gjithë ata që trokasin në ato dyert që ndajnë lirinë e rrejshme prej lirisë së vërtetë. Kujdes nga dajanët edhe kur ju sjellin dhuratata!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Dy superndeshje në Grupin F

“Epoka e re”

MILANO, 6 NËNTOR - Dy ndeshje të zjarra pritet të zhvillohen sonte (e martë) në Grupin F të Ligës së Kampionëve. Në “San Siro” do të përballen Milani dhe Paris Saint-Germainu. Italianët e kanë të detyrueshme fitoren nëse mendojnë ende për kualifikim në garën më të fortë në futboll. Kuqezinjtë kanë vetëm dy pikë nga tri ndeshjet e zhvilluara, ndërsa PSG-ja është lidere e grupit me 6 pikë. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Francë ishte PSG-ja që shënoi fitore (3-0). Realizuan Mbappe, Muani dhe Kangin. Në ndeshjen tjetër Borussia Dortmundi e pret Newcastle Unitedin. Këto dy skuadra janë në pozitë dy dhe tre, me nga 4 pikë të grumbulluara. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Angli fituese doli Dortmundi me rezultat 0-1, prandaj edhe në ndeshjen kthese llogaritet favoriti i lehtë. Në Grupin



H, Barcelona kryeson me 9 pikë dhe ndeshjen e radhës e zhvillon ndaj Shakhtar Donetskut nga ora 18:45. Shakhtari ka vetëm tri pikë të grumbulluara dhe nëse mendon për kualifikim, duhet ta nxjerrë të paktën një pikë. Në ndeshjen tjetër Porto llogaritet favorite absolute ndaj Royal Antwerpit. Portugezët kanë 6 pikë nga tri ndeshje dhe me fitore do të ishin edhe më afër kualifikimit në fazën tjetër, derisa

skuadra e Arbnor Mujës është ende në kërkim të pikëve të para. Kampionët e Manchester Cityt do të përballen me Young Boysin, nga e cila ndeshje presin tri pikët e plotë për ta vazhduar bilacin pozitiv me të gjitha ndeshjet e fituara. Në ndeshjen tjetër Leipzigu i shkon Crvena Zvezdas për t'i marrë pikët për kualifikim. Në Grupin E situata është e paqartë. Atletico Madridi është e dyta në

GRUPI E		GRUPI G	
21:00 Atletico Madrid - Celtic 21:00 Lazio - Feyenoord		21:00 FK Crvena Zvezda - RB Leipzig 21:00 Man. City - Young Boys	
Tabela		Tabela	
	Pikë		Pikë
1. Feyenoord	6	1. Manchester City	9
2. Atletico Madrid	5	2. Leipzig	6
3. Lazio	4	3. Young Boys	1
4. Celtic	1	4. Crvena Zvezda	1
GRUPI F		GRUPI H	
18:45 B.Dortmund - Newcastle Uni. 21:00 AC Milan - PSG		18:45 Shakhtar Donetsk - Barcelona 21:00 FC Porto - Royal Antwerp	
Tabela		Tabela	
	Pikë		Pikë
1. PSG-ja	6	1. Barcelona	9
2. Dortmund	4	2. Porto	6
3. Newcastle	4	3. Shakhtar	3
4. Milan	2	4. Royal Antwerp	0

grup me 5 pikë dhe e pret Celticin që ka vetëm një pikë dhe renditet

në vendin e fundit. Në ndeshjen tjetër Lazio luan ndaj Feyenoordit.

Davisi, sërish MVP i javës në Superligë

PEJE, 6 NËNTOR - Në fundjavë u zhvillua xhiroja e shtatë në Prince Caffè Superligë, apo e fundit e ciklit të parë. Peja ka vazhduar me fitore, kësaj radhe ndaj Bashkimit. Sërish më i dalluari ishte Justin Davis me dyshifror të dyfishtë, me 28 pikë, 11 kërcime e gjashtë asistime, duke pasur indeksin 38 apo më të lartin e kësaj xhiroje. Proton Cable Prizreni regjistroi fitoren e dytë në këtë edicion, duke mundur

Istogun, ndërsa më i dalluari ishte qendra Urim Zenelaj me 22 pikë e 15 kërcime, duke hyrë në Top 5 të javës. Fitore shumë të rëndësishme shënoi Golden Eagle Ylli ndaj Trepçës, ku hero për therandasit ishte Henrik Sirko. Ai ishte vendimtar sidomos në vazhdimë, duke ndihmuar therandasit të triumfojnë në Mitrovicë. Vëllaznimi regjistroi fitoren e tretë radhazi, kësaj radhe me rikthim kundër Sigal



Prishtinës, ku kuqezinjtë ishin të pandalshëm, sidomos në dhjetë minutat e fundit. Më të merituarit për këtë fitore ishin Jalen Ray me 22 pikë, pesë kërcime dhe pesë asistime dhe Samuel Sessoms me 20 pikë, nëntë kërcime dhe dy asistime.

MVP

JUSTIN DAVIS (PEJA)

Top pesëshja

Justin Davis (Peja) 28 pikë, 11 kërcime, 6 asistime, 38 indeksi
Urim Zenelaj (Proton Cable Prizreni) 22 pikë, 15 kërcime, / asistime, 30 indeksi
Henrik Sirko (Golden Eagle Ylli) 18 pikë, 8 kërcime, 1 asistim, 28 indeksi
Jalen Ray (Vëllaznimi) 22 pikë, 5 kërcime, 5 asistime, 25 indeksi
Samuel Sessoms (Vëllaznimi) 20 pikë, 9 kërcime, 2 asistime, 18 indeksi

Kosova pëson humbje ndaj Anglisë

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës U17 ka zhvilluar ndeshjen e dytë në kuadër të grupit 9 të turneut kualifikues për Kampionatin Evropian “Qipro 2024”. “Dardanët” u mposhtën nga Kombëtarja e Anglisë me rezultat 5-, në stadiumin “Ivan Lajlak-Ivić” në Zagreb. Të përzgjedhurit e Arbnor Morinës nuk e patën aspak të lehtë përballë një kombëtareje shumë të fortë siç

është Anglia, prandaj edhe rezultati ishte aq i thellë. “Dardanët” pësuan herët, kur në minutën e 16 realizoi Jesse Derry. Vetëm tetë minuta më vonë i njëjti futbollist sulmi sërish portën e Kosovës, duke realizuar golin e dytë dhe duke bërë që pjesa e parë të përmbyllet 2:0. Në fillim të pjesës së dytë përzgjedhësi Morina bëri dy zëvendësime, futi në lojë Arti Morinajn dhe Leart Bekollin në



vend të Hektor Krasniqit dhe Diar Rexhepit, të cilët nuk arritën ta ndryshojnë rrjedhën e lojës, pasi

që menjëherë në minutën 46 Anglia shënoi për 3:0 përmes qendërsulmuesit Collum Olusesi. Ai e gjeti rrugën e golit edhe në minutën e 63-të për shifrat 4:0. Në minutën 68 Arbnor Morina vendosi t'i zëvendësonte Fatjon Haxhiun dhe Floni Selimin me Edor Hajdinin dhe Skifter Mustafajn. Pavarësisht prej ndryshimeve në formacion, ishte e pamundur të ndërronte edhe rezultati. Anglia vazhdoi edhe më

tej të mos e lë të qetë portën e Kosovës, duke shënuar sërish. Rezultatit përfundimtar e vendosi Luca Fletcher në minutën e 73-të. Në çerekun e fundit të lojës Morina i dha hapësirë për lojë edhe Dior Ilazit në vend të Engjell Krasniqit. Ndeshjen e fundit Kosova e zhvillon më 9 nëntor kundër Ishujve Faroe, e cila, po ashtu, ka pësuar humbje të thella në dy ndeshjet e para.

Kapiteni Dedaj: Fitore me vlerë të shumëfishtë

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në Hendboll, Valon Dedaj, ka thënë se fitorja ndaj Sllovakisë në Prishtinë ka vlerë të shumëfishtë. Dedaj e kishte të pamundur të luajë në Sllovakë, ndërsa mungesa e tij u vërejt shumë. Të dielën në Prishtinë hendbollisti me përvojë solli

qetësi dhe stabilitet në lojën e Kosovës. “Fitorja ishte shumë e mirë për Kombëtaren, por edhe për ne lojtarët. Po të pësonim edhe në këtë ndeshje do të binim shumë edhe në EHF. Fitorja në shtëpi është e mirë në mënyrë që ta kthejmë besimin e tifozëve dhe që numri i shikuesve të jetë më i

madh në ndeshjen e ardhshme. Sa herë që luajmë në Kosovë është e vështirë për kundërshtarët”, ka thënë Dedaj. “Në kombëtare kemi lojtarë të rinj. Për ta fitorja ishte shumë me rëndësi për të fituar vetëbesim. Kanë munguar disa lojtarë pasi edhe në Sllovakë do të fitonim”, ka shtuar Dedaj.



Khudistët e Kosovës gjatë 10 viteve kanë fituar 23 medalje në kampionate evropiane

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Xhudo vazhdon të mbetet sporti që i dhuron Kosovës më së shumti suksese. Shumë medalje të arta, të argjendta e të bronzta kanë ardhur në Kosovë nga

kampionate madhore. Që nga viti 2013 kur Federata e Xhudos së Kosovës është pranuar zyrtarisht, shumë medalje janë fituar nga khudistët e Kosovës. Kosova ka

fituar në total 23 medalje, vetëm në Kampionate Evropiane të xhudos. Nga 23 medaljet e fituara në evropiane, shtatë prej tyre janë të arta, katër të argjendta

dhe 12 të bronzta. Edhe në kampionatin e fundit evropian, mbajtur në Montpellier të Francës, khudistët e Kosovës u rikthyen në vend me medalje.



Muhamet Hyseni, 'Ylli i javës' në Superligë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Futbollisti i skuadrës së Llapit, Muhamet Hyseni, është futbollisti më i mirë për javën e 13-të në Albi Mall Superligë. Komisioni vlerësues vendosi që çmimi "Ylli i Javës" t'i jepet Muhamet Hysenit, pasi ai shënoi dy gola në derbin kundër Prishtinës dhe u shfaq i rrezikshëm për portën e bardhekaltërve të kryeqytetit gjatë tërë ndeshjes.

Hyseni realizoi në minutat 54-t dhe 67, duke e përmbysur rezultatin, por golat e tij nuk i mjaftuan Llapit t'i gëzohet fitores, pasi Prishtina barazoi shifrat në minutën e 77. Pasi mori këtë çmim qendërsulmuesi i llapjanëve u shpreh i lumtur për vlerësimin dhe paraqitjen e mirë në derbi, teksa nuk e fshehu zhgënjimin që skuadra e tij nuk ia doli t'i gëzohet fitores në "Fadil Vokri", pasi pothuajse gjatë tërë pjesës së dytë kishte epërsi numerike në fushë



pas përjashtimit të Useinit me karton të kuq. "Është një ndjenjë shumë e mirë dhe privilegj për mua, pasi është hera e dytë që shpalleme më i miri i javës. E falënderoj ekipin e Llapit, bashkëlojtarët dhe gjithë stafin për mbështetjen dhe që më motivojnë të vazhdoj të rriem edhe më shumë. Kemi qenë një pjesë të madhe të ndeshjes në epërsi

numerike në fushë dhe ishim në epërsi në rezultat, por nga një pakujdesi pësuam gol dhe fatkeqësisht e mbyllëm ndeshjen në barazim. I kemi pasur disa rezultate jo të mira, disa barazime, por besoj se shumë shpejt do të vijmë te fitorja sepse 'Legjendat' e meritojnë për mbështetjen që na japin në çdo ndeshje", ka theksuar Hyseni për faqen zyrtare të FFK-së.

Golden State dorëzohet në fushën e Clevelandit, triumfojnë Phoenixi e Dallasi

CLEVELAND, 6 NËNTOR - Skuadra e Golden States u mund me rezultat 115-104 në fushën e Clevelandit, një ndeshje ku të gjithë titullarët e Cavaliersit realizuan mbi 10 pikë. Mitchell me 31 pikë e Garland me 24 ishin më të mirë për Clevelandin, duke i bërë të pavlefshme 28 pikët e Curryt për Warriorsin. Jashtë fushe fiton Toronto, që falë 30 pikëve e 11 reboundeve të Bamersit, mundi me rezultat 123-116 San Antonion. Mirë u paraqitën për kanadëzët edhe Anunoby e Schroder me nga 24 pikë secili, ndërsa 26 pikët e Johnsonit për



Spursin mbetën për statistikë. Fitoren e parë e korri Memphis, që mundi me shifrat 112-100 Portlandin jashtë fushës. Bane merr 30 pikë e Jacksoni me 27 ishin liderë në fushë për miqtë. Fiton edhe ekipi

i Phoenixit, që falë 41 pikëve të Durantit, mundi me rezultat 120-106 Detroitin. Nuk zhgënjën skuadra e Dallasit, që mundi me rezultat 124-118 Charlotten, ku shtatë lojtarë të ekipit teksan realizuan mbi 10 pikë.

REZULTATET

Detroit - Phoenix	106-120
San Antonio - Toronto	116-123
Cleveland - Golden State	115-104
Dallas - Charlotte	124-118
Portland - Memphis	100-112

Përfundon viti për Pavardin

Mbrojtësi i Interit, Benjamin Pavard, nuk do të jetë në gjendje të rikthehet në fushën e blertë përpara vitit 2024, pasi u lëndua në ndeshjen ndaj

Atalantëes (1-2). Klubi italian ka njoftuar se pas të gjitha testeve mjekësore rezultoi se mbrojtësi francez nuk do të jetë në gjendje të luajë për

rreth dy muaj. "Benjamin Pavard iu nënshtrua vlerësimit klinik dhe të gjitha testeve të nevojshme mjekësore këtë mëngjes në Institutin

Humanitas në Rozzano. Testet konfirmuan dëmtimin në gjurin e tij të majtë. Mbrojtësi francez do të duhet të mbajë mbajtëse funksionale për 3/4

javë, para se ta fillojë stërvitjen i diferencuar dhe e gjitha si periudhë pritëse të zgjasë rreth dy muaj", ka njoftuar skuadra "zikaltër".

SHKURT

Luis Diaz kërkon lirim e babait

Lojtari kolumbian i Liverpoolit, Luis Diaz, po lutet për lirim e babait të tij, i cili është rrëmbyer nga persona të armatosur muajin e kaluar. "Çdo sekondë, çdo minutë ankthi ynë rritet. Nëna ime, vëllezërit e motrat e mia dhe unë jemi të dëshpëruar, të shqetësuar dhe në mungesë të fjalëve për të përshkruar atë që po ndiejmë. Kjo torturo do të marrë fund vetëm kur ta kemi me vete në shtëpi", ka thënë Luis Diaz. Pasi shënoi kundër Lutonit të dielën, Diaz ngriti fanellën e tij për ta zbuluar mesazhin e tij që shkruante: "Liri për babain tim". Prindërit e lojtarit të Liverpoolit u rrëmbyen nga rebelët e krahut të majtë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në qytetin e tyre të lindjes më 28 tetor. Nëna e tij është gjetur dhe liruar, kurse babai i tij mbetet ende i zhdukur.

Real 'blindon' edhe Militaon

Real Madridi është duke menduar për xhevahiret që ka në skuadër dhe kështu klubi spanjoll është duke u rinovuar kontratat edhe duke u vendosur klauzola të frikshme yjeve të tyre. Pas Vinicius Jr dhe Rodrygo, Eder Militaon do të nënshkruajë gjithashtu një kontratë të re me Real Madridin së shpejti. Kontrata në fjalë do të jetë e vlefshme deri në vitin 2028, ashtu siç është rënë dakord një vit më parë. Klauzola e largimit do të jetë e njëjtë si me të brazilianëve të tjerë, 1 miliard euro. Pas Militaon, Valverde dhe Camavinga do të jenë yjet e radhës që do të firmosin kontratën e re me klubin.

Nasri, Mbappes: Mos shko në Real, qëndro 'mbret' në vendin tënd

Ylli i Arsenalit dhe Manchester Cityt, Samir Nasri, në një intervistë për "Le Journal du Dimanche" e ka këshilluar sulmuesin francez Kylian Mbappe të qëndrojë në Paris. "Nëse ai largohet do të lërë një boshllëk, por me buxhetin që klubi ka do të jetë në gjendje të nënshkruajë me lojtarë të tjerë të kalibrit të lartë. Por ai ka kaq shumë rëndësi, qoftë në kombëtaren franceze apo në klubin e PSG-së. Dy vjet më parë thashë se ishte lojtari më i mirë në botë. Unë ende e besoj atë gjë dhe gjithmonë i kam shprehur mendimet e mia. Të isha unë në vend të tij, do të qëndroja në Paris. Në vend se të shkosh në Madrid, qëndro në Paris dhe fito Ligën e Kampionëve. Nëse Marseille do të ishte në pronësi të Katarit në kohën kur unë luaja për atë klub, nuk do të isha larguar kurrë. Mendoj se është më mirë të jesh mbret në vendin tënd", ka thënë Nasri.

Ancelotti: Nuk jemi të kënaqur me rezultatin ndaj Vallecanos

Real Madridi nuk arriti të marrë më shumë se një pikë në përballjen me Rayo Vallecanon në La Liga. Ky barazim i shkaktoi me zbritjen në vendin e dytë dhe ka ngritur pikëpyetje mbi lojën e "Los Blancos". Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se skuadra e tij luajti mirë, por që nuk i konkretizoi rastet e krijuara. "Sigurisht që nuk jemi të kënaqur me rezultatin. Kemi krijuar shumë mundësi për shënim, por nuk arritëm t'i finalizonim si duhet rastet e krijuara. Nuk mendoj se skuadra ishte e lodhur. Thjesht, kur nuk shënon nuk fiton. Kjo na ndodhi neve, sepse për sa i përket lojës, jam i kënaqur me paraqitjen e bërë nga ekipi. Nuk më shqetëson mungesa e golit, sepse ne krijuam dhe kjo është shumë e rëndësishme në futboll", ka deklaruar Ancelotti.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Zyrtar Ligjor
Departamenti: Juridik
I raporton: Drejtorit të Departamentit Juridik
Niveli i gradës: 6

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësisë:

- Asiston në përbushjen e detyrave të përgjithshme të Departamentit Juridik;
- Siguron që korniza ligjore e bankës qendrore është në pajtim me ligjet, rregulloret, rregullat dhe politikat e procedurat relevante si dhe me standardet më të mira ndërkombëtare dhe direktivat e Bashkimit Evropian;
- Merr pjesë në hartimin dhe përditësimin e kornizës ligjore të bankës qendrore;
- Ofron këshilla/opinione ligjore;
- Shqyrton kontrata, marrëveshje dhe dokumente tjera ligjore me të cilat sigurohet administrim efektiv dhe efikas i bankës qendrore;
- Shqyrton rastet ligjore dhe jep rekomandime profesionale për veprime të mëtejme ndërlidhur me to;
- Ndërmerr veprime ligjore brenda autorizimeve dhe përgjegjësi të deleguara;
- Bashkëpunon ngushtë me departamentet dhe divizionet tjera të bankës qendrore në çështje ligjore me qëllim të sigurimit të konsistencës ligjore e rregullative si dhe pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi;
- Sipas autorizimit, përfaqëson dhe mbron interesat e bankës qendrore para gjykatave dhe institucioneve tjera përkatëse;
- Përpilon parashtrës ligjore, sipas kërkesës dhe nevojave të parashtruara;
- Kujdeset për respektimin e të gjitha afateve ligjore në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
- Përkujdeset për mbrojtjen e reputacionit të bankës qendrore, me fokus të veçantë në mbrojtjen e reputacionit ligjor të saj;
- Sipas autorizimit, merr pjesë në komisione dhe grupe përkatëse punuese brenda dhe jashtë bankës qendrore;
- Përgatitë raporte dhe evidenca lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësi të Departamentit Juridik;
- Kryen detyra të tjera të caktuara sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Dituritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë;
- Njohuri të sistemit ligjor dhe ligjeve të Kosovës, veçanërisht atij të sistemit financiar, të punës, mbi procedurën administrative/kontestimore, përbarimore, marrëdhëniet e detyrimeve, etj;
- Njohja e legjislacionit të Bashkimit Evropian është përparësi;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;

Përvoja e kërkuar:

- Minimum 2 vite përvojë pune profesionale në fushën ligjore;

Kërkesat e posaçme:

- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Ruajtja e fshehtësisë afariste.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTI) ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **21 nëntor 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**
- Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e shpalljes do të kontaktohen.**



KONKURS SLOBODNOG RADNOG MESTA

Položaj: Pravni službenik
Odeljenje: Pravno
Izveštava: Direktoru Pravnog odeljenja
Nivo stepena: 6.

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u ispunjavanju opštih dužnosti Pravnog odeljenja;
- Obezbeđuje da je pravni okvir centralne banke u skladu sa odgovarajućim zakonima, propisima, pravilima i politikama i postupcima, kao i sa najboljim međunarodnim standardima i direktivama Evropske unije;
- Učestvuje u izradi i ažuriranju pravnog okvira Centralne banke;
- Daje pravne savete/mišljenja;
- Razmatra ugovore, sporazume i druge pravne dokumente koji obezbeđuju delotvornu i efikasnu administraciju Centralne banke;
- Razmatra pravne predmete i daje stručne preporuke za dalje postupke u vezi sa njima;
- Preduzima pravne radnje u okviru dodeljenih ovlašćenja i odgovornosti;
- Usko saraduje sa drugim odeljenjima i osecima Centralne banke u pravnim pitanjima u cilju obezbeđivanja zakonske i regulatorne doslednosti, kao i uskladenosti sa važećim zakonodavstvom;
- Po ovlašćenju zastupa i brani interese Centralne banke pred sudovima i drugim odgovarajućim institucijama;
- Sastavlja pravne podneske, prema zahtevu i predstavjenim potrebama;
- Brine o poštovanju svih zakonskih rokova u skladu sa važećim zakonskim okvirom;
- Stara se o zaštiti ugleda Centralne banke, sa posebnim osvrtnom na zaštitu njenog pravnog ugleda;
- Po ovlašćenju učestvuje u odgovarajućim komisijama i radnim grupama unutar i van Centralne banke;
- Priprema izveštaje i dokaze u vezi sa obavljanjem poslova unutar odgovornosti Pravnog odeljenja;
- Obavlja druge dodeljene dužnosti na zahtev nadređenog.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava;
- Poznavanje pravnog sistema i zakona Kosova, posebno o finansijskom sistemu, radu, o upravnim/parničnom postupku, izvršnom postupku, obligacionim odnosima itd;
- Poznavanje zakonodavstva Evropske unije je prednost;
- Tečan govor i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno iskustvo:

- Najmanje 2 godine stručnog radnog iskustva u oblasti prava;

Posebni zahtevi:

- Pažnja na detalje, jasna formulacija i tačnost;
- Sposobnost komunikacije u pisanju, kao i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Održavanje poslovne poverljivosti.

Svi kandidati trebaju dostaviti sledeće dokumente:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propatno (motivaciono) pismo, u kome se ističe interesovanje za ovaj položaj;
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (TRUST) ili drugi odgovarajući dokumenti, koji služe za dokazivanje radnog iskustva;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo trebaju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte, koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Krajnji rok za prijavu je **21. novembar 2023**.
- Prijava se može izvršiti mrežno (<https://hris.bkk-kos.org>) putem zvanične internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org.
- Nepotpune dokumentacije se neće razmatrati.**
- Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË
SHOQËRISË
"SA Financial Holding " LLC

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit të Shoqërisë, të plotësuara dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë "SA Financial Holding " L.L.C., shoqëri me përgjegjësitë kufizuara, me numër unik identifikues 811915761 ("Shoqëria") ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË me datë 06/11/2023

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet në vlerën prej 200,000.00 përkatësisht nga vlera e regjistruar **1,630,000.00 Euro** në **1,430,000.00Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

"SA Financial Holding " L.L.C., Rr. Bekim Fehmiu, objekti Arting, Kati 1, 10000 Prishtinë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Rec Kos" Sh.p.k, K. Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "Rec Kos" Sh.p.k, K. Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.12.2023 në ora 10:00 në Shkollën fillore "Luigj Gurakuqi" në fshatin Flamuras (Sankoc), Komuna Glllogoc (Drenas), do të organizohet Debat Publik nga Kompania "Rec Kos" Sh.p.k, K. Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Qëndren grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike, grumbullim të vajrave të përdorura si mbeturinat nga paisjet elektrike, në Z.K. Sankoc, K. Glllogoc.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b25251MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Rec Kos" Sh.p.k, K. Fushë Kosovë, për Qëndren grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike, grumbullim të vajrave të përdorura si mbeturinat nga paisjet elektrike, në Z.K. Sankoc, K. Glllogoc.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Emri i biznesit: Lum Gashi B.I. Emri Tregtar: D.P.H. "Flow" me NRF:600731500 shpall të pavlefshme Certifikatën e Numrin Fiskal me numër: 600731500 të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ose Administrata Tatimore e Kosovës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Pashk Jakaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Atë Gjergj Fishta".

- Hanemsha Cesko shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini" Prizren.

- Fatbardha Aliu shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Ismail Dumoshi" Obiliq.

- Valon Ibrahim shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Metro Gaming Center" SH.P.K. me nr. 811047457.

- "Laguna" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330165078.

- Liridon Hoti shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Valton Kerqeli shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- VILDANE HAJZERI, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "HASAN PRISHTINA".

- Endrita Dragusha shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- QERKIN ISMAJLI, shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Qendra e Aftësimin Profesional Mitrovice-kursi kuzhinier me numër: 99/2009.

- Izet Perzhaku shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.



Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundesi vazhdimi)

I. Emërtimi i vendit të punës: Drejtor/e Teknik/e

Përgaditja profesionale: Fakulteti Teknik, niveli MSc apo Inxh. i diplomuar

Përvoja e punës: Tri (3) vite përvoja pune, prej tyre së paku dy (2) vite menaxheriale

Numri i kryesve: (1)

Koeficienti i pagës: 991.25 Euro

Kushtet të veçanta: - Njohja e kompjuterit (word, Exel, Auto Cad etj), Certifikimet dhe trajnime shtesë me përparësi.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Përgjegjës kryesore për drejtimin e Drejtorisë Teknikë duke filluar nga Planifikimi, Organizimi, Udhëheqja,
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Zyrтарin/en Kryesor/e Financiar/e dhe Menaxherët/et Operativ,
- Planifikon aktivitetet teknike të drejtorisë duke përfshirë të gjitha sektorët e ujit të pijes dhe ujërave të ndotura,
- Të përcjell Objektet prodhuese të ujit, kualitetin e ujit,
- Organizon dhe udhëheq me të gjitha departamentet teknike për shërbime efikase dhe te përditshme të Kompanisë,
- Koordinimin e punëve dhe operacioneve për nevoja të kompanisë në nivel rajonal,
- Organizon dhe udhëheq me personelin e te gjitha departamenteve teknike në mënyrë efikase dhe njëkohësisht monitoron dhe kontrollon aktivitetet e përditshme të kompanisë,
- Përkujdeset për një mirëmbajtje efikase me kosto të ulët të shpenzimeve,
- Merr pjesë në hartimin dhe implementimin e Planit të Biznesit, mirëmbajtjen, prodhimin dhe investimet kapitale si dhe bashkëpunon ngushtë me Institucionet e vendit dhe Donatorë të ndryshëm,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrat të Kryeshefit Ekzekutiv,
- Për punën që kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë.

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Referencat,
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënvra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>, si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data **07.11.2023** deri me datën **21.11.2023**
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranura të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.
- Përparësi kanë kandidatet me përvojë pune në sektorin e ujërave.
- Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisin dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtët nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

I. Naziv radnog mesta: Tehnički direktor

Profesionalna kvalifikacija: Tehnički Fakultet, Magistar ili diplomirani inženjer

Radno iskustvo: Tri (3) godine, od kojih najmanje dve (2) godine iskustva u rukovodstvu

Broj pozicija: (1)

Koeficijent plate: 991.25 €

Posebne veštine: Poznavanje rada na računaru (Word, Excel, Auto Cad, itd.), sertifikati i dodatne obuke.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Može da obavlja poslove sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Ima glavnu odgovornost za upravljanje tehničkom direkcijom, uključujući planiranje, organizaciju, upravljanje;
- Obavezuje se da blisko saraduje sa glavnim izvršnim direktorom, komercijalnim direktorom, glavnim finansijskim direktorom, operativnim menadžerima;
- Planira tehničke aktivnosti direkcije, uključujući sve sektore voda za piće i kanalizacionih voda;
- Prati objekte za proizvodnju vode i kvalitet vode
- Organizuje i upravlja svim tehničkim odeljenjima za efikasne i ažurirane usluge kompanije
- Koordinira radove i poslovanje za potrebe preduzeća na regionalnom nivou
- Organizuje i efikasno rukovodi osobljem svih tehničkih odeljenja i prati i kontroliše dnevne aktivnosti kompanije;
- Obezbeđuje efikasno održavanje uz niske troškove;
- Učestvuje u izradi i sprovođenju poslovnog plana, održavanja, proizvodnje i kapitalnih investicija i blisko saraduje sa nacionalnim institucijama i raznim donatorima;
- Izveštava svoj rad kod glavnog izvršnog direktora kompanije.

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diploma sa univerziteta u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Reference,
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od **07.11.2023 do 21.11.2023**.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.
- Prednost imaju kandidati sa radnim iskustvom u sektoru voda.
- Regionalno Vodovodno Preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.

